Përmirësimi i mjedisit të biznesit në Shqipëri

Prof. Dr. Shyqyri Llaci
Prof. Dr. Vasilika Kume

Duke lënë mënjanë problemet e tjera, tashmë jemi të ndërgjegjësuar se procesi i transformimit të ekonomisë sonë u shoqërua me disa tipare të veçanta të bizneseve të reja në zhvillim, të cilat duhet të përballen me vështirësi dhe me probleme të ndryshme. Në ditët e sotme, ndërkohë që konkurrenca e tregut pritet të jetë më e ashpër dhe mjedisi është duke ndryshuar me shpejtësi, po bëhet gjithnjë e më evidente nevoja për të rritur efektshmërinë në drejtim të bizneseve.

Strategjia afatmesme për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme

Strategjia afatmesme e miratuar nga Qeveria në vitin 2001 përfshiu disa objektiva:

- Zhvillimi institucional dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë - donatorëve të huaj dhe komunitetit të biznesit.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor e fiskal.
- Përmirësimi i drejtimit operacional të biznesit të vogël dhe të mesëm (SME).
- Përmirësimi i sistemit kreditues të SME-ve.
- Mbështetja e zhvillimit të SME-ve, për të patur ekuilibër sektorial dhe rajonal (agro-biznesi, rajonet e pazhvilluara, promovimi i bizneseve të reja në këto rajone).

Barrierat administrative për biznes

Disa gjetje të vrojtimit të inicuar nga qeveria në pranverën e vitit 2002 me ndihmesën e Shërbimit të Investimeve të Huaja:

- Bizneset nuk janë të kënaqura qoftë për cilësinë e rregulloreve dhe të kërkesave administrative, qoftë për sjelljen burokratike që i prek ato në Shqipëri.
- Rezulton që fushat më problematike për operimin dhe për rritjen e bizneseve janë rregulloret e doganave dhe administrimi i taksave.
- Drejtimi i bizneseve shpenzon mesatarisht 10.5 për qind të kohës së tij duke u marrë me kërkesa administrative dhe rregullatore.
- Procesi i regjistrimit është i kushtueshëm dhe shpenzon kohë.
- Mjedisi i përgjithshëm i biznesit në Shqipëri është ndërmjet pozicionit, i moderuar dhe jo shumë mbështetës.

Politikat e Qeverisë në mbështetje të SME-ve

Për të përmirësuar mjedisin e biznesit:

- Janë hartuar dhe janë zbatuar politika specifike për ristrukturimin e ish-ndërmarrjeve shtetërore.
- Zhvillimi i SME-ve ka kaluar nëpër disa politika institucionale forcuese në 3 nivele (strategjike, taktike dhe operacionale).
- Një kuadër pozitiv i parashikueshëm ligjor e fiskal, konstruktiv për zhvillimin e SME-ve (i përbërë nga një bazë të dhënash për ligjet dhe masat fiskale që prekin SME-të, shqyrtimi i legjislacionit të hartuar etj.).
- Një program trajnues gjithëpërmbledhës për përmirësimin e drejtimit operacional të SME-ve.

Mundësia e përgjithshme për të hyrë në financime

Megjithatë:

- Mundësia e SME-ve për t'u financuar nga burime të ndryshme është mjaft e vështirë.
- Një numër i madh i SME-ve, që kërkuan hua në një etapë të caktuar të zhvillimit të tyre ose nuk arritën ta merrnin atë, ose tërhoqën kërkesën e tyre para se të merrej vendimi.
- Normat e larta të interesit cituar nga burimet e huadhënies përbëjnë arsyen kryesore për mospranimin e dhënies së huave ndaj SME-ve.
- Sektori bankar shqiptar ende nuk ka arritur të krijojë mekanizmat e duhur për qëllime të vlerësimit të rrezikut dhe, gjithashtu, i mungon profesionalizmi në vlerësimin e planeve të biznesit.
- Njohuritë sipërmarrëse janë një arsye tjetër e marrë në konsideratë kryesisht nga bankat, gjatë vlerësimit të kërkesës për hua dhe kështu ka një tendencë që firmat e mëdha – më tepër sesa firmat e vogla – kanë më shumë mundësi të marrin kredi në qoftë se bëjnë kërkesë.
- Kompanitë e mëdha kanë më shumë mundësi për të qenë të suksesshme në aplikimin e tyre pranë bankave sesa kompanitë e vogla.
- Çmimi i disa linjave të kreditit është në mënyrë jorealiste i lartë, duke rezultuar në norma të ulëta shlyerjeje.

Politika, ndryshimet ligjore dhe proceduriale

Ndryshimet e propozuara në politikat aktuale

- Një rol kyç i Qeverisë do të ishte, të bënte një rishikim të gjithanshëm dhe një përmbledhje të të gjithë legjislacionit, duke monitoruar edhe efektet e tyre ndaj SME-ve.
- Të bëhet një përkufizim konsekuent i SME-ve, me qëllim thjeshtimin e administrimit dhe krijimin e një profili të qartë të politikës së qeverisë ndërmjet ministrive të linjës (të përcaktohen përparësitë e sektorit dhe politikat shoqëruese fiskale).

- Të konsiderohet politika e SME-ve si pjesë integrale e zhvillimit global të sektorit industrial, të politikave rajonale dhe të legjislacionit.
- Strategjia e SME-ve duhet të ketë miratimin dhe marrëveshjen përfundimtare të të gjitha ministrive të linjës, sapo t'u jetë transmetuar atyre.
- Të nxiten politikat e orientuara nga eksporti në sektorë që përdorin burime vendase.
- Të përmirësohet konkurrenca e sektorit privat, duke rishikuar nivelet e TVSH-së.
- Të tregohet kujdes për një politikë eficiente dhe të bazuar mirë për agrobizneset.

Ndryshimet e propozuara për procedurat aktuale

- Për shkak të konkurrencës së pandershme të ekonomisë joformale për të ligjëruar biznese, qeveria duhet të bëjë një përpjekje të fuqishme dhe të qëndrueshme për të pakësuar madhësinë e ekonomisë joformale (nëpërmjet iniciativave tatimore përzgjedhëse).
- Roli i shërbimeve këshilluese në biznes duhet të rritet, duke mbuluar jo vetëm hartimin e planeve të biznesit por edhe marketingun e përzier, kontabilitetin dhe administrimin e kostos.
- Si hap i parë është zhvillimi i një numri procedurash, miratimi i të cilave është i nevojshëm për të filluar një aktivitet apo një biznes të ri (të gjitha llojet e lejeve të lëshuara nga pushteti qendror apo local).
- Më pas, krijimi i një rrjeti qendrash që do të ndihmojnë gjithë investitorët/sipërmarrësit për të filluar veprimtari/biznese të reja.
- Kompjuterizimi i informacionit në nivel kombëtar pranë Drejtorisë së Doganave, me qëllim që të sigurohet informacion për "Universin" e SME-ve.
- Kompjuterizimi i informacionit në nivel kombëtar pranë Drejtorisë së Doganave dhe Drejtorisë së Taksave, me qëllim sigurimin e informacionit për gjithë komunitetin e SME-ve.
- Krijimi i një qendre kombëtare për grumbullimin dhe përpunimin e informacionit lidhur me raportet vjetore të bizneseve private.
- Bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Fakultetit të Ekonomisë dhe INSTAT-it për të zhvilluar, për të ndjekur dhe për të analizuar treguesit e performancës së SME-ve. Përfshirja e treguesve të performancës së SME-ve në Programin Kombëtar të Statistikave Publike.
- Zbatimi i teknikave statistikore bashkëkohore për vlerësimin e ekonomisë joformale.